<p>Bashkia Shkodër mbështet me shërbime funksionimin e kopshteve në Bashkinë Shkodër. Kudo në territor kopshtet duam t'i furnizojmë me energji elektrike pa ndërprerje dhe ujë. Edhe në ato kopshte ku janë evidencuar probleme, në vitin 2021 do të angazhohemi që të sigurojmë këto shërbime në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Shërbimet realizohen nga OSHEE dhe nga UKSH. Për këtë për secilin objekt lidhen kontratat përkatëse të shërbimit dhe në vijim, sipas monitorimit dhe akt rakordimeve përkatëse vijohet më pagesat.</p> <p>Planifikimi për vitin 2022 parashikon financimin e këtyre shërbimeve, bazuar mbi historikun e administrimit të viteve të fundit dhe në zgjidhjen e problemeve të evidetuara.</p> <p>Në Anën e Malit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Energjia elektrike është lidhur në mënyrë të jashtëligjshme, tek kopshti Oblike. • Të lidhet ujësjellësi me kopshtin. Kemi nevojë për një hidraulik që realizojë lidhjen. 						
ii.Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim me energji elektrike dhe uje për të gjitha objektet parashkollore në territorin e Bashkisë Shkodër. • Ofrimin e ketij shërbimi kaq te rendsisem per keto objekte parashkollore. 						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i kontratave ekzistuese dhe lidhjen e kontratave të reja,per ato objekte prashkollore qe kane probleme, • Kolaudimin e matesave si dhe rakordimin sistematik me OSHEE. • Monitorimin e vazhdueshem te shpenzimeve të energjise në të gjitha objektet prashkollore. • Likuidimeve i detyrimit sipas shpenzimit të energjisë së ujit dhe energjisë elektrike. 						
b)Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim me ujë të pijshëm në të gjitha kopshtet në territorin e Bashkisë së Shkodrës • Furnizim me energji elektrike në të gjitha kopshtet në Bashkinë Shkodër. 						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve, OSHEE. Ujësjelles Kanalizime				Bashkia Shkoder		
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Energji elektrike	1,300			1,300	
A.2	Furnizimi me uje	600			600	
Shuma		1,900			1,900	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Energji elektrike	1,300			1,300	
A.2	Furnizim me uje	600			600	
Shuma		1,900			1,900	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Energji elektrike	1,300			1,300	
A.2	Furnizimi me uje	600			600	
Shuma		1,900			1,900	
f)Periudha e zbatimit Janar 2022-Dhjetor 2022 Janar 2023-Dhjetor 2023 Janar 2024-Dhjetor 2024			g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve. Institucioni likuidues: Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve.			

Nr.8	P09120.O1.A16 Sigurimi i transportit për shërbimet e arsimit parashkollor.	Funksioni:9 ARSIMI N/Funksioni: 091 Arsimi parashkollor dhe baze. Llojet e programit: 09120.Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor.								
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:										
i.Situata										
Drejtorja e Çerdheve siguron shpërndarjen e ushqimeve çdo ditë në 7 kopshtet me drekë. Për këtë kemi mjetin e poqëm frigoriferik dhe personeli e angazhuar për të kryer shërbimin. Në buxhetin e vitit 2022 planifikojmë shpenzimet e domosdoshme për karburantin, asikuracionin, kolaudimin dhe taksat vjetore të automjetit.										
ii.Synimi i projektit										
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i shpërndarjes,furnizimit ditor të ushqimit për Kopshtet me drekë. • Mirmbajtje e mjetit dhe taksat vjetore. 										
iii.Aktivitetet kryesore të projektit										
<ul style="list-style-type: none"> • Pagesa e taksës vjetore per mjetin frigoriferik qe trasporton ushqimin ditor ne kopshte. • Shpërndarja e ushqimit ne orarin e duhur ne te gjitha kopshtet me dreke. • Mirmbajtja mekanike e furgonit frigoriferik,ne baze te nevojave te amortizimit. 										
b)Rezultatet që prisni										
Shpërndarja e ushqimit ne orarin dhe standartin e duhur ne te gjitha kopshtet me dreke.										
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt						
Drejtorja e Kopshteve dhe Çerdheve				Bashkia Shkoder						
e)Shpenzime te llogaritura										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
						Pa ga	Siguri me	Operative	Transfere	kapitale
A.1	Shpenzime për karburant				200			200		
A.2	Shpenzime të tjera transporti (siguracion,kolaudime te tjera shpenzimet ransporti)				100			100		
	Shuma				300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
						Pa ga	Siguri me	Operative	Transfere	kapitale
A.1	Shpenzime për karburant				200			200		
A.2	Shpenzime të tjera transporti (siguracion,kolaudime te tjera shpenzimet ransporti)				100			100		
	Shuma				300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
						Pa ga	Siguri me	Operative	Transfere	kapitale
A.1	Shpenzime për karburant				200			200		
A.2	Shpenzime të tjera transporti (siguracion,kolaudime te tjera shpenzimet ransporti)				100			100		
	Shuma				300			300		
f) Periudha e zbatimit Janar 2022-Dhjetor 2022 Janar 2023-Dhjetor 2023 Janar 2024-Dhjetor 2024					g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kopshteve dhe e Çerdheve. Institucioni likuidues: Drejtorja e Kopshteve dhe e Çerdheve.					



Nr.7	P09120.O1.A17 Furnizim me ushqime për Kopshtet në Bashkinë e Shkodrës	Funksioni:9 ARSIMI N/Funksioni: 091 Arsimi parashkollor dhe baze. Llojet e programit: 09120. Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor.				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i.Situata						
<p>Në bashkinë Shkodër janë në funksion 7 kopshte me drake:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopshti "Ismet Sali Bruçaj" (Soros) ka 140 fëmijë të regjistruar • Kopshti "Ton Alimhilli" ka rreth 124 fëmijë të regjistruar Kopshti "Bep Tusha" ka 90 femije. • Kopshti "Guerrile" (Ngjyrat) ka 62 fëmijë të regjistruar • Kopshti "1 Qershori" ka 30 femije fëmijë të regjistruar • Kopshti "Edit Durhan"ka 30 femije, fëmijë të regjistruar • Kopshti "Njomzat" ka 38 fëmijë të regjistruar <p>Në total, në kopshtet me drekë frekuentojnë rreth 300 fëmijë të cilët marrin vaktin e drekës. Për ushqyerjen e fëmijëve përgatitet menuja ditore sipas normativave të përcaktuara, përllogaritet vlera dhe specifikimet teknike për artikujt ushqimorë, vijohet me procedurën e prokurimit dhe realizimin e shërbimit. Kuota ditore përllogaritet mesatarisht 140 lekë/fëmijë.</p>						
ii.Synimiiprojektit						
Ofrimi i shërbimit në standart për sigurimin e mirërritjes së fëmijëve në kopshtet me drekë..						
iii.Aktivitetet kryesore të projektit						
<p>Vlerësimi i nevojave Përllogaritja sipas artikujve e fondit limit të prokurimit Realizimi i procedurave të prokurimit public Realizimi i shërbimit Monitorimi i shërbimit Likuidimi i detyrimeve kontraktuale për shërbimin e realizuar</p>						
b)Rezultatet qëprisni						
Mirërritje e fëmijëve në kopshtet në Bashkinë Shkodër.						
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve Prindërit Fëmijët				Prinderit		
e)Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
				Paga	Sigurime	Operative
A.1	Furnizim me ushqime	11,100			11,100	
Shuma			11,100			11,100
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
				Paga	Sigurime	Operative
A.1	Furnizim me ushqime	11,500			11,500	
Shuma			11,500			11,500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:		
				Paga	Sigurime	Operative
A.1	Furnizim me ushqime	11,500			11,500	
Shuma			11,500			11,500
f)Periudha e zbatimit Janar 2022-Dhjetor 2022 Janar 2023-Dhjetor 2023 Janar 2024-Dhjetor 2024				g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve. Institucioni likuidues: Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve.		



Nr.9	P09120.O1.A18 Mirembajtje e zakonshme per ndertesat e arsimit parashkollor.	Funksioni: 9 ARSIMI N/Funksioni: 091 Arsimi parashkollor dhe baze. Llojet e programit: 09120. Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor.
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i.Situata		
<p>Ndërtesat e sistemit arsimor parashkollor për të qënë sa më të përshtatshme dhe komode për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve kanë nevojë për mirëmbajtje, si lyerje me bojë dhe riparime të ndryshme. Në territorin e Bashkisë ka gjithsej 58 Kopshte me sipërfaqe gjithsej prej 6972 m² ku duhen mirëmbajtur minimalisht me lyerje. Vetëm kopshtet në qytet me drekë kanë këto sipërfaqe:</p> <p>Kopshti “Ismet Sali Bruçaj”(Soros) ka 450 m² + oborr 900m²,. Kopshti “Ton Alimhilli”, ambjente në përdorim ka afërsisht 430 m² + oborr 1000m²,. Kopshti “Bep Tusha” ka ambjente në përdorim 500 m² brenda dhe jashtë. Kopshti “Guerrile” ambjente në përdorim ka rreth 80m²,. Kopshti “1 Qershori” në përdorim ka rreth 70 m². Kopshti “Edit Durhan” ambjente në përdorim ka rreth 450m². Kopshtet “Periferi” në NJA të Bashkisë Shkodër sipas prioriteteve.</p> <p>Gjatë vitit 2022 është parashikuar të mirëmbahen kopshtet sipas vlerësimit teknik dhe ndër të tjera duke adresuar problemet e dala nga diskutimi me drejtues të kopshteve dhe prindër në dëgjuesat publike, si më poshtë:</p> <p>Qyteti Shkoder: Kopshti «Bep Tusha»</p> <ol style="list-style-type: none"> Në kopshtin “Bep Tusha” është bërë rikonstruksion i pjesshëm. Është një kopësht që ka kushte optimale. Në hyrje të kopshtit është një shesh ku parkojnë makinat prinderit, shesh që mendojmë se ka nevojë për rikualifikim (asfaltim, gjelbërim, ...) Kopshti “Bep Tusha” ka një kaldajë të vjetër, që nuk funksionon. Ngrohja nuk është optimale. Bashkejtesa e çerdhes dhe e kopshtit është shumë e mire. Çerdhja ka rikonstruksion të plotë, që nga A-ja deri tek germa e fundit. Kopshti tek “Azem Hajdari” është në kushte optimale. Tualetet janë të përbashketa me shkollën. Nëse në ndonjë projekt të afërt mund të ndryshohet, të ndahet për t’i shërbyer vetëm fëmijëve të kopshtit. <p>Kopshti “Ismet Sali Bruçaj:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sistemi i ngrohjes është shumë i amortizuar.Është e nevojshme të ketë një sistem qendror ngrohjeje. <p>Kopshti “Fetah BArbullushi”</p> <ol style="list-style-type: none"> Një rikonstruksion të tualeteve të kopshtit. Të bëhet një ndarje e oborrit nga shkolla <p>Njësia administrative Ana e Malit</p> <ul style="list-style-type: none"> Tek hyrja e kopshtit duhen bërë kanalizimet sepse në periudhën e dimrit është e pamundur që të kalohet. <p>Njësia administrative Dajç:</p> <ol style="list-style-type: none"> Në kopësht,tek hyrja e shkollës kërkohet lyerje e pjesshme dhe ka nevojë për rregullime në tualete.. Edhe ne kopshtin e fshatit Pentar nuk ka tualete dhe transporti vazhdon të mbetet problem. <p>Njësia administrative Guri i Zi</p> <ol style="list-style-type: none"> Është vlerësuar se duhet të hapet një klasë kopshti në shkollën e Jubanit meqënëse janë edhe ambjentet të disponueshme. Gjithashtu kjo kërkon edhe parashikimine kostove të mirëmbajtjes Mungon rrethimi i oborrit të kopshtit në Kuç. Kemi problem me sigurinë sepse kopshti është ngjitur me rrugën. <p>Njësia Administrative Postribë</p> <ol style="list-style-type: none"> Kopshti tek shkolla “Adem Haxhija” ka nevojë që të ndahet tualeti për 2 kopshtet. Kopshti në Kullaj është në gjendje shumë të keqe përsa i përket infrastruktures, shkolla ku ka ambientet kopshti është e braktisur dhe tepër e amortizuar. Te krijohet nje klasë ose ambient për 18 fëmijet që e frekuentojnë kopshtin. <p>Njësia Administrative Rrethina</p> <ol style="list-style-type: none"> Izolimi i terraces se kopshtit ne Dobraq. Sigurimi i lidhjes së rretit për furnizimin me ujë të pijshëm. <p>Njësia administrative Velipojë</p> <ol style="list-style-type: none"> Strehe për të parandaluar shiun para portës së kopshtit. Kopshti pranë shkollës “nikoll Zagoriani” ka nevoje që kopshti të shtrohet me parket sepse është më i nxehtë. 		
ii.Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i këtij shërbimi kaq të rëndësishëm për këto objekte parashkollore, i domodoshëm për përmirësimin e kushteve në institucionet e arsimit parashkollor 		
iii.Aktivitetet kryesore të projektit		

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi dhe përditësimi i nevojave për shërbim në kopshte ▪ Përgatitja e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime; ▪ Realizimi i procedurave të prokurimit; ▪ Realizimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes së personelit, sipas planifikimit; ▪ Monitorim dhe raportim i zbatimit të punimeve ▪ Likuidim i shërbimit të kryer. 						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes të ambienteve të godinave parashkollore.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Sherbime per mirembajtje te objekteve ndertimore	4,069			4,069	
	Shuma	4,069			4,069	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Sherbime per mirembajtje te objekteve ndertimore	4,069			4,069	
	Shuma	4,069			4,069	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Sherbime per mirembajtje te objekteve ndertimore	4,069			4069	
	Shuma	4,069			4069	
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Janar 2022-Dhjetor 2022			Drejtoria e Kopshteve dhe e çerdheve.			
Janar 2023-Dhjetor 2023						
Janar 2024-Dhjetor 2024			Institucioni likuidues: Drejtoria e Kopshteve dhe e Çerdheve			



Nr.19	P09120.O1.A19 Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve teknike	Funksioni: 9 ARSIMI N/Funksioni: 091 Arsimi parashkollor dhe bazë. Llojet e programit: 09120. Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Gjatë procesit të punës në kopshtet me drekë kërkohet mirëmbajtje e aparateve dhe pajisjeve teknike si lavatrice, frigoriferë nëpër kopshtet e ndryshme. Ato kanë nevojë për riparime gjatë vitit.						
ii. Synimi i projektit						
Synohet plotësimi i nevojave emergjente dhe të nevojshme për mirëmbajtjen e aparateve dhe pajisjeve teknike që të jenë përherë në gjëndje pune.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Frigoriferëve ,lavatriceve, aristonëve, kompjuterave etj që lidhen me funksionin normal të punës.						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së aparateve dhe pajisjeve teknike						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Kopshteve dhe e Cerdheve				Bashkia Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me kapit ale
A. 1	Shpenzime për mirembajtje të aparateve dhe paisjeve teknike.	30			30	
A. 2	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	120			120	
	Shuma	150			150	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me kapit ale
A. 1	Shpenzime për mirembajtje të aparateve dhe paisjeve teknike.	30			30	
A. 2	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	120			120	
	Shuma	150			150	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me kapit ale
A. 1	Shpenzime për mirembajtje të aparateve dhe paisjeve teknike.	30			30	
A. 2	Shpenzime për kalibrim Kaldaje	120			120	
	Shuma	150			150	
f) Periudha e zbatimit vitit 2021, 2022, 2023				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kopshteve dhe e Cerdheve. Institucioni likuidues: Drejtoria e Kopshteve dhe e Cerdheve		



Nr. 20	P.09120.O2.A1 "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë"	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni: 091. Arsimi parashkollor dhe bazë. Llojet e programit: 09120 Arsim bazë përfshirë Arsimin parashkollor.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Festivali i zërave "Bilbilat e vegjël këndojnë" është iniciativë e Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Kujtim Alija" në Shkodër, Kjo iniciativë lindi 20 vjet më parë, në prill të vitit 1996 si shprehje e nevojës së fëmijëve të Shkodrës për të shpalosur talentin e tyre në fushën e interpretimit.</p> <p>Kjo veprimtari që në nisje angazhoi një numër shumë të madh fëmijësh, mësuesit e muzikës së tyre si dhe specialistë të vokalit të qytetit e më gjerë. Kjo veprimtari rezultoi e suksesshme, pasi formati i saj, në shkallë kombëtare u bë burim i disa veprimtarive të mëdha televizive. Për këtë arsye nuk është e rastësishme që fëmijët shkodranë në këto aktivitete u bënë fitues absolutë. Sikurse: R.Gjylbegu, Rr.Smaja, B.Cina, D.Garuci, G.Dume, T.Paçrami, R.Bashi, S.Vjerdha, J.Simoni, A.Ara, etj.</p> <p>Kjo veprimtari, përveç këngëtarëve të skenave zbatimë dhe qytetare ka evidentuar dhe furnizuar me këngëtarë lirikë shkollën e mesme artistike "P.Jakova" (K.Rahimi, A.Lika, R.Rasha, B.Cina.)</p> <p>Bilbilat e vegjël, përveç talenteve ka shërbyer për promovimin e muzikës shqiptare për fëmijë duke u mundësuar mësimin e këtyre këngëve fëmijëve të mbarë qarkut Shkodër, përmes transmetimit televiziv, për një periudhë mjaft të gjatë, janar– prill.</p> <p>"Bilbilat e vegjël" i shton çdo vit dhjetëra zëra të rinj skenave lokale e kombëtare, si rrjedhojë ka nevojë për pasion, përkushtim, investim të përditshëm deri në detajet e vogla.</p> <p>Në vitin 2022 festivali i zërave "Bilbilat e vegjël" do të zhvillohet në katër faza ku parashikojmë të marrin pjesë rreth 2500 fëmijë nga të gjitha shkollat në territorin e Bashkisë Shkodër. Shkollat do paraqesin fëmijë që kanë talent e dëshirë, pa kufizim në numër, të cilët do t'i nënshtrohen punës përgatitore dhe fazave seleksionuese, nën udhëheqjen e specialistëve. Materiali muzikor për të gjithë konkurrentët përcaktohet nga organizatorët në përshtatje me moshën, karakteristikat vokale.</p> <p>Në fazën finale konkurrojnë më të talentuarit e përzgjedhur nga fazat seleksionuese dhe, nga këta, shpallen këngëtarët fitues. E kënduara direkt (Live) përmirësohet vazhdimisht përmes një pune të kualifikuar dhe sigurimit të një zorimi sa më cilësor.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. • Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i grupit të punës, • Ndërtimi i platformës dhe kalendarit të konkurimit. • Vendosja e kontakteve me shkollat, • Krijimi i jurive të seleksionimit dhe vlerësimit • Bashkëpunimi me krijues dhe aranzhues • Bashkëpunimi me Televizionet. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e traditës e suksesit të gjatë 20 vjeçar • Evidentimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e këngës. • Përshtatje e materialit muzikor me karakteristikat vokale të këngëtarëve të vegjël • Kthimi kësaj veprimtarie në një proces të gjatë të mësimit të këngës së zgjedhur shqiptare për fëmijë si dhe këngës qytetare dhe zbatimë shqiptare apo e popujve të tjerë. • Zbulimi dhe përgatitja e talenteve direkt në shkolla deri tek skajet më të largëta të territorit të Bashkisë Shkodër • Pjesëmarrje e gjerë e fëmijëve dhe e prindërve në këtë aktivitet që në fazat e para në të gjitha zonat e Shkodrës. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Fëmijët, Q. K. e Fëmijëve, drejtoritë e Shkollave 9 vjeçare, Specialistë të zgjedhur të vokalit, kompozitorë, mësuesit e muzikës, aranzhues, skenarist e scenograf.				Bashkia Shkodër, Q. K. e Fëmijëve,		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me kapitale



A.1	Honorare: - Skenari 10.000 lekë dita për person - Orkestracion 20.000 lekë Skenografi (maket+realizim) 50.000 lekë - Të ftuar 20.000 lekë dita për person - Moderimi 10.000 lekë dita për person 2-3 dite - Koncertmaester 8.000 lekë dita për person - Juri,Faz.seleksionuese 1.200 lekë dita për person - Juri,Faz.finale 2.400 lekë dita për person	349			349		
A.2	Stimuj (dhurata për fituesit)	69			69		
	Shuma	418			418		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	kapitale
	Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	418			418		
	Shuma	418			418		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	kapitale
	Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	418			418		
	Shuma	418			418		
f) Periudha e zbatimit vitit 2022, 2023, 2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit					



Nr. 21	P.09120.02.A2 Festivali 60-të Kombëtar për fëmijë	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni: 091. Arsimi parashkollor dhe bazë. Llojet e programit: 09120 Arsim bazë përfshirë Arsimin parashkollor.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Shkodra, djepi i këngës qytetare, më 10-11 maj 1963 me angazhimin e <u>forcave krijuese të qytetit</u>, organizoi festivalin e parë të këngës për fëmijë. Ditët e festivalit u bënë ditët e “gjallesës” të një “sedre tradicionale kulture” të qytetit, kurse jehona e tij i shtyu organizatorët të vazhdonin rrugën e nisur.</p> <p>Festivali u bë kombëtar në vitin 1966. Me të u plotësua një boshllëk i ndjeshëm në edukimin muzikor të fëmijëve. Por krahas muzikës, Festivali u dha fëmijëve mundësinë të qëndronin së bashku. Shkodra u bë edhe një nga vendet më të dashura për fëmijët nga e gjithë Shqipëria. Emocionet e konkurimit i takonin skenës. Jashtë saj lindën njohje dhe miqësi të reja.</p> <p>Vitet “90 shënuan risi të tjera. Edicioni i 31-të, në vitin 1992, përfshiu krijuesit dhe interpretuesit nga të gjitha trojet shqiptare, duke e kthyer Festivalin në Festival Mbare shqiptar të Këngës për Fëmijë. Ai vijoi të jetë ngjarja artistike më e rëndësishme për fëmijë. Kënga iu përgjigj ndryshimeve, por ruajti veçantinë, fizionominë kombëtare dhe vlerat artistike.</p> <p>Festalet patën ngritje cilësore edhe në organizim: u rrit hapësira skenike me dekore të mëdha, u realizuan librete të zgjedhura e prezantime origjinale ; arti regjisorial synoi daljen në pah të lirshmërisë në interpretim dhe talentit të ekzekutuesve të vegjël.</p> <p>Skena e këtij festivali në vite u bë rrugë për një shumicë këngëtarësh që u bënë të shquar dhe fushë veprimtarie për kompozitorë, skenaristë, autorë tekstesh, regjisorë, koreografë, skenografë, dirigjentë, instrumentues, orkestrues, mjeshtra vokali, etj.</p> <p>Festivali Mbarëkombëtar i këngës për fëmijë i radhës, i 60-ti, parashikohet të zhvillohet në fillim të muajit qershor 2022. Kjo gjë vazhdon ta mbajë këtë veprimtari si festë të këngës shqiptare dhe të mundësojë ndjekjen nga një shumicë artdashësish të qytetit të Shkodrës, trevave të tjera shqiptare dhe një shumësie të madhe të shqipfolësve nëpërmjet transmetimit satelitor dhe faqeve të Facebookit.</p> <p>Edicioni i 60-të, do promovojë 18 këngë të reja, që do jenë interpretimet më të mira të krijimeve më të zgjedhura të kompozitorëve, poetëve, aranzhuesve dhe këngëtarëve të këtij viti në realitetin shqiptar të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe diasporës.</p> <p>Realizimi i këtij Festivali, i vetmi i këtij lloji në realitetin shqipfolës, do ruajë dhe do çojë përpara traditën e gjatë e të suksesshme të këtij zhanri; do të stimulojë talentin e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së zërimit dhe punës së kualifikuar, në të kënduarën direkt (Live).</p> <p>Meqenëse Festivali zhvillohet në prag të pushimeve verore, një ndër synimet shtesë është edhe paraqitja e këtij eventit në qendrat më të mëdha turistike, si pjesë e argëtimit të fëmijëve.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. • Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i planit të punës, • Krijimi i grupit të punës, • Vendosja e kontakteve me krijuesit e të gjitha trevave, • Krijimi i komisionit të seleksionimit dhe vlerësimit, • Seleksionimi dhe organizimi i grupeve të mëdha vokale dhe baletit, • Bashkëpunimi me institucionet e tjera. • Furnizimi dhe blerja e shërbimeve dhe të logjistikës për realizimin e festivalit. ðrganizimi i festivalit. • Monitorimi dhe raportimi. • Realizimi i pagesave për shërbimet dhe personelin, e artistet e angazhuar. 		
b) Rezultatet që prisni		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ruajtja e suksesit dhe traditës së gjatë 59 vjeçare 2. Pasurimi i fondit të këngës shqiptare për fëmijë. 3. Evidentimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e këngës. 4. Kthimi i veprimtarisë në festë të këngës përgjatë gjithë ditëve të provave dhe koncerteve. 5. Rritja e atraksionit turistik e kulturor të Shkodrës nëpërmjet realizimit të Festivalit në pedonalen kryesore të qytetit. 6. Pjesëmarrje e gjerë e fëmijëve së bashku me prindërit në këtë aktivitet dhe stimuli i lidhjes së tyre. 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	



Fëmijët, Q. K. e Fëmijëve, Shkollat 9 vjeçare, Krijues bashkëpunëtorë, muzikantë dhe këngëtarë të vegjël nga të gjithë trevat shqipfolëse, media të ndryshme e televizioni publik shqiptar.		Bashkia Shkodër, Q. K. e Fëmijëve, Teatri Migjeni, Qendra Kultures Pjeter Gaci				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e
A. 1	Skenografi, ndricim dhe foni	1,000			1,000	
A. 2	Honorare Krijimtari dhe realizues dhe cnime	1,640			1,640	
	Honorare Autori i muzikës (18 persona x 20.000 lekë)					
	Honorare Autori i tekstit (18 persona x 10.000 lekë)					
	Honorare Orkestruesi (18 persona x 20.000 lekë)					
	Honorare Inxhinier Audio (1 persona x 100.000 lekë)					
	Honorare Udhëheqës Artistik (1 persona x 100.000 lekë)					
	Honorare Skenari (1 persona x 30.000 lekë)					
	Honorare Skenograf (1 persona x 100.000 lekë)					
	Honorare Regjizor (1 persona x 50.000 lekë)					
	Honorare Moderator (1 persona x 50.000 lekë)					
	Honorare Derigjent (2 persona x 50.000 lekë)					
	Honorare Koordinator (1 persona x 100.000 lekë)					
A.3	400.000 lekë për fëmijët	400			400	
A.4	Honorare Promocion (1 persona x 100.000 lekë)	100			100	
A.5	Materiali Promocioni	100			100	
A.6	Çmime 30. 000 leke per fituesin	300			300	
A7	Honorare Gupi organizator i punes (2500/person/muaj)	500			500	
Total		4,040			4,040	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e
A. 1	Festivali 60-të Kombëtar për fëmijë	4,040			4,040	
Total		4,040			4,040	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e
A. 1	Festivali 60-të Kombëtare për fëmijë	4,040			4,040	
Total		4,040			4,040	
f) Periudha e zbatimit vitit 2022, 2023, 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit			



Nr. 22	P09120.O2.A3 Veprimtari masive (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni: 091. Arsimi parashkollor dhe baze. Llojet e programit: 09120 Arsim baze përfshirë Arsimin parashkollor
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Qendra Kulturore e Fëmijëve organizon gjatë vitit, sipas kalendarëve të përcaktuar. disa veprimtari masive sportive, artistike e shkencore, mbi bazën të platformave që ndërton dhe ua shpërndan shkollave 9 vjeçare</p> <p>Këto veprimtari gjallërojnë dukshëm sheshet, fushat sportive, palestrat dhe sallat që ka qyteti ynë. Nga më kryesoret veçojmë:</p> <p><u>në gjashtë mujorin e parë Janar-Qershor</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <u>Kampionati i shahut në mes shkollave 9 vjeçare</u>(rreth 30 shkolla) Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem (CU) – 2 vajza dhe 2 djem nga kl 5-6 2 vajza dhe 2 djem nga klasa 7-8-9 <u>Kampionati i pingpongut në mes shkollave 9 vjeçare</u>(rreth 30 shkolla) Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga 5-6 2 vajza dhe 2 nga klasa 7-8-9 <u>Kampionatet pranverore në Basketboll, Volejball dhe Minifutboll femra dhe meshkuj në mes shkollave 9 vjeçare</u> (rreth 20 shkolla) Kjo veprimtari shumë të madhe realizohet në tri faza mbi shortin që hidhet në fillim dhe veprohet me sistem eliminimi. Zhvillohet në disa terrene dhe palestra të qytetit tonë për arsye të përmasave që ka. dhe zgjat rreth një muaj e gjysmë. Në fund shpallen ekipet fituese për gjithsecilin lloj sporti. <u>Zbavitimi me gjuhët e huaja</u> Marrin pjesë anëtarët e rretheve të gjuhëve të huaja të QKF(150fëmijë) si dhe nxënës të dalluar në këtë fushë nga shkollat 9 vjeçare. Veprimtaria organizohet në sallën e QKF-së dhe trajtohet si variete ku nxënësit shpalosin arritjet e tyre përmes këngë, recitimit, inskenimit dhe humorit në gjuhë të huaja. <p><u>Në gjashtë mujorin e dytë Shtator Dhjetor</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <u>Kampionati i vrapimit në natyrë</u> në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 30 shkolla) Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga CU-3 vajza dhe 3 djem nga Cikli i Ulët <u>Konkursi i fjalës artistike</u> në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 27 shkolla) Konkursi zhvillohet në tre faza sipas kalendarit të përcaktuar. Faza e parë, në shkolla, pa kufizim numrin i konkurrenteve, ndiqet nga specialistët e QKF-së. Faza e dytë në sallën e QKF në 10 ditë dhe në të marrin pjesë nga çdo shkollë: 3 recitues nga CU- 2 recitues nga CL dhe Një nxënës ose një grup në fushën e humorit. Nga kjo fazë Juria përzgjedh finalistët të cilët konkurrojnë në Finale për të shpallur 8 fituesit: Vendi i parë, dytë, tretë dhe inkurajues për CU dhe për CL. <u>Garë me biçikleta</u> në mes kopshteve të qytetit Marrin pjesë nga çdo kopësht 2 vajza dhe 2 djem. Gara zhvillohet e ndarë, në pedonalen tek ura e Bunës. Ky aktivitet hyn tek aktivitetet e traditës(rreth 30 vjet që zhvillohet) dhe rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët por edhe nga prindërit. Kjo ditë kthehet në një festë për këtë brez fëmijësh. Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar në fushat respektive, angazhohen edhe mësuesit edukimit fizik, të letërsisë, trajnerë, gjygtarë, regjisorë, aktorë, moderatorë dhe shkrimtare nga më të dalluarit që ka qyteti ynë. Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyre të cilët stimulohen. Këto veprimtari ndiqen me shumë interes nga drejtuesit dhe tekniket e klubit shume sportesh “Vllaznia” që shënojnë dhe seleksionojnë, për të afruar në ekipet e këtij klubi më të talentuarit. 		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. Gjallërimi i jetës sportive, kulturore e artistike të këtij brezi gjatë gjithë vitit kalendarik Zgjerimi i bazës së këtyre veprimtarive duke përfshirë dhe shkollat e periferisë Zhvillimi dhe ruajtja në nivele optimale e cilësive fizike dhe psikomotorre të fëmijëve Zbulimin dhe përgatitjen e talenteve të reja në fushën e sportit Zbulimin dhe përgatitjen e fëmijëve të talentuar në fushën e interpretimit skenik dhe humorit Planifikimi për këto veprimtari është bërë mbi territorin e vjetër të Bashkisë Shkodër me mendimin për të tentuar zgjerimin e gjeografisë për këtë vit. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		



-Përcaktimi i platformave respektive për secilën veprimtari -Ndërtimin e kalendarëve respektive -Hedhjen e shortit -Përcaktimi i gjyqtarëve dhe jurive -Përcaktimi i grupeve realizuese -Ndërtimi dhe regjistrimi i ekipeve pjesëmarrëse -Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me drejtoritë e shkollave -Bashkëpunimi						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Aktivizimi në kohën e lirë të brezit të fëmijëve me veprimtari sa të bukura dhe interesante aq edhe të shëndetshme për këtë brez. Gjallërimi gjatë gjithë vitit i jetës kulturore e sportive në qytetin e Shkodrës. Inkurajimi tek fëmijët i pavarësisë krijuese lëvizore dhe i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe bashkëvepruese në procesin e të ushtruarit me të tjerë. Ruajtja dhe avancimi i traditës së gjatë mbi 60 vjeçare të organizimit të kampionateve sportive dhe garës së interpretimit nga ana e QKF-së. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Qendra Kulturore e Fëmijëve "Kujtim Alija", drejtoritë e Shkollave 9 vjeçare, Nxënës, artistë, sportistë të dalluar, specialiste të sportit dhe artist etj.				Bashkia Shkoder, Q. K. e Fëmijëve,		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operativ	Transferime
A.1	Honorare: Gjyqtarë (12 persona X 1200 leke për person x 4 dite) Ant.jurie (5 persona X 1200 lekë dita për person X 8 dite) Moderimi (1 person X 6000 lekë) - Skenografi 40000 lekë - Skenari 10000 lekë	209			209	
A.2	Stimuj (dhurata për fituesit)	71			71	
Shuma		280			280	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operative	Transferime
Shuma		280			280	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operative	Transferime
Shuma		280			280	
f) Periudha e zbatimit vitit 2022, 2023, 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit Bashkia Shkoder Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit			



Nr. 23	P.09120.O2.A4 Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni: 091. Arsimi parashkollor dhe bazë. Llojet e programit: 09120 Arsिम bazë përfshirë Arsimin parashkollor.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Viti 2016 për një pjesë të funksionimit të QKF-se "Kujtim Alija" ishte problem pasi u ndërpre mbështetja e DAR Shkodër për rrethet jashtëshkollore. Në të tilla kushte Q.K.F "Kujtim Alija" ,e mbështetur nga Bashkia pjesë e së cilës ajo është tashmë, u organizua dhe me dashamirësinë e një grupi instruktorësh pasionantë në punën me fëmijët arriti të ruaj traditën gati 70 vjeçare të punës me disa nga rrethet jashtëshkollore më të kërkuara, me rezultate dhe të dashura nga fëmijët. Kjo veprimtari funksionon që me krijimin e këtij institucioni dhe ka përfshirë në çdo vit rreth 500 fëmijë të Shkodrës të talentuar në fushat respektive të cilët argëtohen, aftësohen dhe stërviten pranë kësaj qendre nga një grup specialistësh të artit, sportit e shkencës nga më të mirët që zhvillojnë aktivitetet në qytetin tonë. Nga kjo veprimtari e suksesshme në vite kanë dalë figura të spikatura të artit e sportit që kanë shkëlqyer në skenat dhe fushat sportive kombëtare e më gjërë.</p> <p>Viti 2020 shënon një tjetër sfidë për QKF-në, me pretendimin për të plotësuar kushtet që të tre sektorët të kompletohen me numrin e rretheve që kërkon kurikula e këtij institucioni.</p> <p>Në këto kushte në si staf kemi menduar, diskutuar e planifikuar për t'u përshtatur në kushtet e reja në të cilat ndodhemi duke propozuar zgjidhjen që ashtu si u veprua në 2016-tën të krijohet mundësia e zgjerimit të veprimtarive.</p> <p>Në vitin 2022 duam të shtojmë edhe 5 rrethe të tjera të edukimit duke plotësuar strukturën e funksionit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, kërkesë kjo e ardhur nga fëmijët dhe mësuesit në Q.K.F "Kujtim Alija"</p> <p>Fushat e edukimit ku fëmijët janë të aktivizuar në rrethe janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anglisht 2. Italisht 3. Frengjisht 4. Gjermanisht 5. Matematikë 6. Dekor 7. letërsi 8. Estradë 9. Pikturë 10. Fizarmonikë 11. Piano 12. Kitarrë 13. Tunxh 14. Punime me baltë, skulpturë 15. Baskeboll 16. Balet 17. Volejball 18. Pingpong 19. Futboll 20. Shah 		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Gjallërimi i jetës kulturore, artistike, sportive e shkencore, të këtij brezi gjatë gjithë vitit kalendarik • Zbulimin dhe përgatitjen e talenteve të reja në fushën e artit, sportit e shkencës • Evidentimin dhe paraqitjen në publik të artistëve e sportistëve të talentuar që ka Shkodra për këtë moshë. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)		
<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i strukturës • Ndërtimin i planeve të punës së rretheve • Përcaktimi dhe sigurimi i bazës materiale që duhet për zhvillimin normal të këtyre kurseve. • Seleksionimi, regjistrimi dhe ndërtimi i ekipeve dhe grupeve. • Vendorsja e kontakteve dhe bashkëpunimi me shkollat • Ndërtimi i orarit 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> • Zbulimi dhe përgatitja e talenteve të reja në fushën e artit, sportit e shkencës • Mbushja e kohës së lirë të brezit të fëmijëve të sotëm me aktivitet konkret • Gjallërimi gjatë gjithë vitit i jetës kulturore, sportive e shkencore në qytetin e Shkodrës. • Inkurajimi tek fëmijët i pavarësisë krijuese lëvizore dhe i marrëdhënieve bashkëpunuese dhe bashkëvepruese në procesin e të ushtruarit me të tjerë. • Ruajtja dhe avancimi i traditës së gjatë mbi 60 vjeçare të funksionimit të rretheve jashtëshkollore nga ana e QKF-së. 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
Q. K. e Fëmijëve "Kujtim Alija", specialiste të artit, sportit e shkencës Nxënës të dalluar në fushën e artit, sportit dhe shkencës	Bashkia Shkoder, Q. K. e Fëmijëve,	
e) Shpenzimet e llogaritura		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare: Ora e mësimit 275 lekë 24 ore për instruktore në muaj	1,362			1,362		
	Shuma	1,362			1,362		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare: Ora e mësimit 275 lekë 24 ore për instruktore në muaj	1,362			1,362		
	Shuma	1,362			1,362		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Honorare: Ora e mësimit 275 lekë 24 ore për instruktore në muaj	1,362			1,362		
	Shuma	1,362			1,362		
f) Periudha e zbatimit vitit 2022,2023,2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Ekonomike Arsimit Bashkia Shkodër Institucioni likuidues: Drejtoria Ekonomike Arsimit				



Nr. 24	P.09120.O2.A5 Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 - vjeçare	Funksioni. 9 ARSIMI N/Funksioni: 091. Arsimi parashkollor dhe bazë. Llojet e programit: 09120 Arsिम bazë përfshirë Arsimin parashkollor				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Mbrëmja tradicionale e vitit të ri ka një traditë më shumë se 60 vjeçare, realizuar pa ndërprerje çdo vit nga QKF (ish Shtëpia e pionierit) në fund të muajit dhjetor, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër. Ajo stimulon nxënësit e talentuar pa dallime, që zgjidhen nga shkollat, DAR-i dhe stafi i QKF. Kjo mbrëmje shërben si premierë e talenteve të humorit, këngës, baletit dhe aerobisë së QKF dhe si stimulim i nxënësve më të mirë të qytetit; (stimulohen rreth 70 nxënës të dalluar të ciklit të ulët të shkollave 9 vjeçare dhe 130 artistë dhe sportistë të vegjël). Materiali artistik i kësaj veprimtarie është rreth 75%, krejt i ri. Gjithashtu kjo mbrëmje stimulon bashkëpunimin me artistë të afirmuar, të cilët ftohen si mysafirë nderi. Kjo gjë rrit interesin dhe pëlqyeshërinë dhe e bëjnë këtë aktivitet shumë argëtues.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të rritet cilësia e jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. Identifikimi i talenteve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. • Zgjerimi i bazës së kësaj veprimtarie me nxënës të talentuar edhe nga shkollat e periferisë që administrojnë bashkia e re e Shkodrës. • Gjallërimi i jetës kulturore e artistike të brezit të fëmijëve në kuadër të festave të fund vitit • Evidentimi i arritjeve të fëmijëve në mësimet në art dhe sport. • Bashkëpunimi me artistë e specialistë të fushave të ndryshme nën udhëheqjen e QKF-së. • Realizimi i një Premiere sa më argëtuese dhe cilësore për të gjithë fëmijët e qarkut Shkodër, përmes transmetimit televiziv. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
- Përcaktimi i grupit realizues - Realizimi i skenarit - Përzgjedhja e materialeve muzikore dhe koreografike - Përcaktimi i aktorëve, solistëve, gr. vokale, gr. të baletit e aerobisë - Vendosja e kontakteve me DR, Drejtoritë e shkollave dhe trupat pedagogjike - Bashkëpunimi me Televizionet.						
b) Rezultatet që prisni						
1. Evidentimi dhe paraqitja në publik e nxënësve të dalluar të shkollave 9 vjeçare dhe e talenteve të reja në fusha të ndryshme të shkencës, artit dhe sportit. 3. Afishimi i arritjeve të këtyre talenteve në veprimtaritë lokale e kombëtare. 4. Ruajtja dhe përparimi i traditës mbi 60 vjeçare 5. Trajtimi në skenar i temave të dashura por edhe i atyre që shqetësojnë brezin e fëmijëve të sotëm.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Q. K. e Fëmijëve, drejtoritë e Shkollave 9 vjeçare, Nxënës, artistë, sportistë të dalluar, shkrimtarë, aktorë, aranzhues, regjisor, koreograf, skenograf Koncertmaester etj.				Bashkia Shkodër, Q. K. e Fëmijëve,		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2022		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Stimulimi i nxënësve dhe artisteve të dalluar 185 vete x 1350 lekë për person = 249.750 lekë	250			250	
A.2	Krijimtaria dhe realizimi Libreti+materiale humoristike 40.000 Skenografi(materiale+realizim) 50.000 Rregjia 20.000	195			195	
A.3	Aktor i ftuar (për person) 12.000					



		Shuma	445			445		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023			Tot ali (mijë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapital e
A.1	Stimulimi i nxënësve dhe artisteve të dalluar 185 vete x 1350 lekë për person = 249.750 lekë	250				250		
A.2	Krijimtaria dhe realizimi Libreti+materiale humoristike 40.000 Skenografi(materiale+realizim) 50.000 Rregjia 20.000 Balet (për person) 8.000 Aktor i ftuar (për person) 12.000 Orkestracion 25.000	195				195		
Shuma		445				445		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024			Tot ali (mijë)	Nga kjo:				
				Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapital e
A.1	Stimulimi i nxënësve dhe artisteve të dalluar 185 vete x 1350 lekë për person = 249.750 lekë	250				250		
A.2	Krijimtaria dhe realizimi Libreti+materiale humoristike 40.000 Skenografi(materiale+realizim) 50.000 Regjia 20.000 Balet (për person) 8.000 Aktor i ftuar (për person) 12.000 Orkestracion 25.000	195				195		
Shuma		445				445		
f) Periudha e zbatimit vitit 2022,2023,2024				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja Ekonomike Arsimit Bashkia Shkodër Institucioni likuidues: Drejtorja Ekonomike Arsimit				



P09120.O3.A1 Rikonstrukcion i tualeteve shkolla "Branko Kadia"

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/ sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt Idea	Rikonstrukcion i tualeteve shkolla Branko Kadia
Problemet për t'u adresuar	Amortizimi i tubacioneve Prania e lagështirës në tualete dhe në korridore Dëmtimi i hidrosanitareve Bllokimi i shpeshtë i shkarkimeve Mungesa e hidroizolimit të pllakave Mungesa e një tualeti për personat me aftësi të kufizuar Mungesa e tualeteve sipas standardit për 256 nxënës
Emri i Programit	Arsimi bazë
